

INTERVISTË ME EKSPERTIN GJERMAN PËR BALLKANIN, BODO WEBER

Gjithçka varet nga BE-ja

“Autonomia” për veriun e Kosovës mund të ndodhë pa e rrezikuar bosnjizimin e Kosovës vetëm nëse në rregullimin e saj institucional “autonomia” është një lloj i “Ahtisaarit plus” pa e përdorur atë emër. Nëse jo, ajo do të rrezikonte të shndërrohet në një derë të hapur për ndarje të mëvonshme të Kosovës, që do të thotë humbje të veriut, thotë analisti Bodo Weber

Agron Bajrami

Dialogu mes Kosovës dhe Serbisë ka për qëllim normalizimin e raporteve mes dy vendeve, por ky do të jetë një proces i gjatë që mund të marrë shumë vite. Megjithatë, procesi po e shtyn Beogradin drejt njohjes graduale të realitetit të Kosovës së pavarur. Kështu thotë eksperti gjerman për Ballkanin, Bodo Weber, në një intervistë për “Kohën Ditore”. Weber, që është shkolluar pranë Këshillit për Politikë të Demokracizimit, thotë se dialogu Kosovë - Serbi po shënon përparim prejse është ndryshuar Qeveria në Serbi, ndërsa një masë të madhe të meritave për shtyrje të këtij procesi në drejtimin e duhur ai i jep kancelares gjermane, Angela Merkel, dhe kushtëzimeve që ajo ia bëri Serbisë në lidhje me Kosovën.

Megjithatë, Weber tërheq vërejtjen për rreziqet që kërcënojnë nëse procesi nuk adreson paqartësitë në lidhje me zgjidhjet e mundshme, sidomos kur flitet për veriun e Kosovës. Një autonomi për veriun, në formën e “Ahtisaarit plus”, do të mund të ishte e pranueshme vetëm nëse ajo nuk rrezikon të shndërrohet në një derë të hapur për ndarje të mëvonshme të Kosovës, apo krijim i një Republika Srpske në veri të Kosovës, që do ta bosnjizonte Kosovën.

Ai po ashtu sheh rrezik edhe nga vetë Bashkimi Evropian dhe ndasitë që ekzistojnë brenda tij.

Koha Ditore: Si do ta vlerësonit dialogun deri më tani? Shihni përparim dhe nëse po, a mund të jetë ky përparim i përhershëm?

Weber: Duhet ndarë dialogun në dy faza – dialogu gjatë mandatit të presidentit Tadiq dhe dialogu i tanishëm me President të ri në Serbi dhe një qeveri të re.

Përkatësisht, që kur Gjermania, do të thotë kancelarja Merkel, e mori leadershipin e BE-së në gusht të vitit 2011, dhe u përball me Beogradin. Faza e parë ishte e karakterizuar nga përpjekjet e regjimit të Tadiqit që të manipulojë me BE-në në mënyrë që t’u ikte koncesioneve substanciale në “dialog” aq sa ka qenë e mundur. Në fazën e dytë, të tanishmen, shohim përparim të vazhdueshëm,

sado të kufizuar, në bazë të asaj që Beogradi është vënë përpara zgjidhjes mes Kosovës, që në fakt është vetizolimi, apo integrimi në BE.

KD: A është “normalizimi” i mundur nëse Serbia vazhdon të mbajë pozicionin e tanishëm se ajo kurrë nuk do ta njohë Kosovën si të pavarur, ndërsa Kosova insiston në qëndrimin se nuk do të diskutojë çështjet e brendshme me Serbinë?

Weber: Këto janë deklaratat ideologjike, maksimalistike, që tashmë janë në kontradiktë me dialogun konkret. Qeveria e tanishme në Beograd në fakt ka nisur të lëvizë drejt njohjes së realitetit të pavarësisë së Kosovës, me gjithë retorikën konfliktuoze. Dhe në një rrethanë të tillë, të vendosur nga bashkësia ndërkombëtare, që Prishtina të diskutojë me Beogradin rreth çështjes së brendshme të Veriut të Kosovës në fakt do të ndihmojë në lëvizjen drejt kthimit të veriut në një çështje të brendshme të Kosovës.

KD: Si i shihni platformën dhe rezolutën që Serbia i miratoi së voni në lidhje me Kosovën?

Weber: Platforma reflekton sfidën e tanishme të elitës sunduese në Serbi për të përkufizuar rrethin si katror – përpjekjes që të pajtojë të kaluarën dhe bindjet e tyre nga vitet 1990-të me realitetin e vitit 2013. Më interesante se sa platformë është transformimi nëpër të cilin ajo kaloi në rrugën e vet nga përmbajtja e platformës deri në tekstin e rezolutës parlamentare.

KD: Cilat janë rreziqet dhe pasojat negative të dialogut? A shihni ndërlidhje mes dialogut dhe përqjesimit të situatës së pari në veri të Kosovës e më pas edhe në Luginën e Preshevës?

Weber: Rreziku kryesor i dialogut të tanishëm është se çka do të ndodhë nëse BE-ja, për shkak të konflikteve të brendshme, nuk e mbanë kursin e tanishëm. Ka një konflikt të përhershëm në anën e BE-së të cilin njeriu më së miri e sheh në Berlin. Në njërin anë, e kemi menaxhimin e konfliktit Serbi - Kosovë nga ana e BE-së përmes procesit të integritimit në BE, ndërsa në anën tjetër kriza e BE-së pro-

vokon më shumë skepticizëm dhe më pak përkrahje brenda Unionit për politikën e vet të zgjerimit. Kancelarja Merkel bën komente të rregullta në lidhje me nevojën për të ngadalësuar integrimin në BE pas hyrjes së Kroacisë. Kjo kontradiktë e përhershme nuk do të shpjgërë në një ndalje të zgjerimit, për shkak se as BE-ja nuk mund t’i përballojë pasojat që një gjë e tillë mund t’i ketë, e as shtetet e Ballkanit Perëndimor nuk kanë ndonjë alternativë tjetër përveç perspektivës evropiane. Por do ta bënte punën e BE-së më të lehtë nëse Gjermania dhe qeveritë e tjera që kërkojnë nga Beogradi koncesione të rënda njëkohësisht të mbajnë një pikë më të fuqishme brenda BE-së për interesin strategjik të Unionit në vazhdimin e politikës së zgjerimit në Ballkan.

Një tjetër rrezik qëndron në çështjes se sa stabile është Qeveria e tanishme në Serbi. Nëse do të ketë, sikur që thonë disa, zgjedhje të parakohshme në Serbi, kjo do të krijonte një ndalim në negociatë.

Sa për Luginën e Preshevës, nuk duket e qartë se çka e shkaktoi konfliktin atje, por ashiqare se ishte një mundësi e mirëpritur për Daçiqin që të mbulojë koncesionet që kishte bërë në dialog me disa deklaratat të fuqishme populiste.

Sa i përket veriut, është e qartë se çdo lëvizje nga ana e Beogradit drejt pranimit të realitetit të Kosovës së pavarur do të krijojë njëkohësisht rezistencë në veri.

KD: E shihni autonominë për veriun e Kosovës në shkëmbim për ulëse në OKB si një shkëmbim të mundshëm?

Weber: Nëse “autonomia” shndërrohet në një emër për një zgjidhje institucionale për veriun të bazuar në ato që janë në Planin e Ahtisaarit, atëherë po. Përndryshe, nuk ka gjasa për një shkëmbim të tillë me Prishtinën. Megjithatë, bazuar në përvojat e kohës së fundit me debatin rreth ulësës në OKB të nisur nga ambasadori gjerman në Serbi, jam në dyshim që çfarëdo hapash të negociuar drejt integritimit të institucioneve të serbëve të Kosovës në veri brenda strukturës shtetërore të Kosovës do të çojnë në afat të shkurtër drejt deblokimit nga ana e



Bodo Weber: “Rreziku kryesor i dialogut të tanishëm është se çka do të ndodhë nëse BE-ja, për shkak të konflikteve të brendshme, nuk e mban kursin e tanishëm”

Beogradit të rrugës së Kosovës drejt OKB-së.

KD: Si mund të jepet autonomia për veriun pa e rrezikuar bosnjizimin e Kosovës?

Weber: Vetëm nëse në rregullimin e saj institucional “autonomia” është një lloj i “Ahtisaarit plus” pa e përdorur atë emër. Nëse jo, ajo do të rrezikonte të shndërrohej në një derë të hapur për ndarje të mëvonshme të Kosovës, që do të thotë humbje të veriut. E madje edhe kjo nuk do të ishte aq keq sa skenari i Bosnjës – ku vendosja institucionale e Republika Srpskas e parandalon funksionimin e shtetit si tërësi, jo vetëm si kërcënim nga secesioni. Por në çdo rast kjo do të ishte e papranueshme edhe për Prishtinën edhe për kryeqytetet e BE-së që e shtyjnë procesin e dialogut. Berlini, për shembull, është shumë i qartë në këtë pikë.

KD: A ka BE-ja kapacitet, vullnet politik dhe stomak që të garantoj çfarëdo marrëveshje që mund të arrihet rreth veriut?

Weber: Mendoj se rruga që është shtruar nga Merkel kur ajo mori leadershipin e BE-së, duke reaguar ndaj dhunës kundër KFOR-it, e krijoj momentumin e vet, për shkak të të cilit BE-ja, Perëndimi do të jenë të detyruar që të garantojnë ato që do të pajtohen rreth veriut në të ardhmen.

KD: Mendoni se ndërmjetësimi i BE-së ka qenë i suksesshëm dhe vizionar deri më tani? E di BE-ja ku do të çojë ky proces përfundimisht?

Weber: Në esencë, ky nuk është ndërmjetësim – është vendosje e Beogradit para zgjidhjes: ose BE-ja ose Kosova – edhe pse në një mënyrë gjysmë të hapur, me një perspektivë afatgjatë. Ky ishte mesazhi i kancelares Merkel në gjysmën e dytë të vitit 2011, dhe kjo e krijoj bazën për “ndërmjetësim”. BE-ja, në fakt vendet kyç që janë përfshirë, në

kuotim të përgjithshëm e dinë se ku duhet të shpjgërë kjo – drejt mundësitimit të një procesi të normalizimit sikur edhe drejt progresit të Serbisë në integrimet e BE-së. Një proces që do të zgjasë shumë vite dhe që në fund do të çojë Serbinë që në një mënyrë kontraktuale të njohë pavarësinë e Kosovës para se të hyjë në BE. Ajo që duket se nuk eksiton është një plan kryesor i detajuar për këtë proces afatgjatë.

KD: A ka rrezik që dialogu të dështojë?

Weber: Vështirë të parashihet, posaçërisht meqë dinamika e brendshme politike në Serbi është mjaft e dhunshme, ndërsa BE-ja dhe kryeqytetet perëndimore as vetë nuk janë të sigurta se si ti qasen kursit të ri të Qeverisë serbe.

Një tjetër çështje e hapur është nëse përparimi në dialog me automatizëm do të mundësojë që 22 vendet brenda BE-së t’i bindin 5 anëtarët mospajtuese që të dakordohen me nisjen e procesit të integritimit në BE për Kosovën – Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit, marrëveshjen e përkohshme tregtare, liberalizimin e vizave. Nëse jo, kjo do të mundë të prodhojë presion ndaj Prishtinës që të braktisë dialogun.

KD: Cilat mendoni se janë pritjet nga dialogu në Berlin?

Weber: Berlini pret që marrëveshjet e negociuara të zbatohen dhe pret që negociatat e tanishme në dialog që një pjesë nga tri grupet e kushteve që Merkel ia prezantoi presidentit serb Tadiq në gusht 2011, dhe që është dashur të lihen jashtë në vendim marrjen e BE-së në lidhje me statusin e kandidatit për Serbinë – shpërbërja e strukturave paralele – të prodhojnë rezultate konkrete. Kjo do të ishte lëvizja kyç që Gjermania të japë përkrahjen e saj në Këshillin Evropian që Serbia të marrë datën për nisjen e negociatave për anëtarësim.

BISEDAT PËR NDRYSHIME NË KABINETIN QEVERTAR PRITET TË PËRMBYLLEN ME MARRËVESHJE TË RE TË KOALICIONIT

PDK-ja e AKR-ja “ristartojnë” koalicionin

vijon nga ballina

Me dorëheqjen e Bedri Hamzës nga posti i ministrit të Financave, si dhe me kalimin e ministrit të FSK-së, Agim Çeku, nga Partia Socialdemokrate e Kosovës në PDK-në e Thaçit, është shtuar presioni i Pacollit ndaj Thaçit për rishikim të ndarjes së posteve ministrorë. Pacolli, që në Qeveri ka hyrë në emër të Koalicionit për Kosovën e Re, ku përveç PSD-së janë edhe disa subjekte tjera të vogla, insiston se i takojnë dikasteret që kanë të bëjnë me politikën ekonomike, duke e përmendur posaçërisht Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, momentalisht e udhëhequr nga Besim Beqaj i PDK-së, si një që duhet t’i takojë atij.

Por, në PDK thonë se çdo kalkulum duhet bërë duke pasur parasysh forcën reale politike të çdo subjekti që është pjesë e Qeverisë.

“PDK-ja ka 36 deputetë, ka 34 për qind të elektoratit, dhe ne kemi një përgjegjësi. Duam t’i japim hapësirë

AKR-së, por nuk mund t’i ikim përgjegjësisë që kemi”, tha për gazetën një zyrtar i lartë i PDK-së, duke lënë të kuptohet se jo gjithçka që kërkohet nga Pacolli edhe mund t’i jepet atij.

Bisedat për “ristartimin” e koalicionit qeverisës mes PDK-së dhe AKR-së janë intensifikuar pas dëshimit të negociatave mes Thaçit e Ramush Haradinajt dhe Aleancës për Ardhmëri të Kosovës, për shkak të refuzimit nga ana e PDK-së që Haradinajt t’ia lëshojë postin e kryeministrit.

Spekulimet

Të shtunën PDK-ja përmes një deklaratë për shtyp ka demantuar Radio Kosovën, e cila, duke u thirrur në burime nga të dyja partitë, ka raportuar se tashmë është arritur marrëveshja për ndryshimet në kabinetin qeveritar.

Radio Kosova ka raportuar se

“çështja e emërimeve pothuajse është vendosur” dhe se “deri javën e ardhshme do të jetë gati përbërja e re” e Qeverisë. Sipas Radio Kosovës, AKR-ja do të marrë Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe aty do të emërojë ministër Fadil Ismajlin e KOST-it, ndërsa PDK-ja do të lëvizë ministrin aktual të MZHE-së në postin e ministrit të Integritimit Evropian, në vend të Vlora Çitakut. Vetë Çitaku, sipas Radio Kosovës, do të transferohet në krye të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në vend të Bajram Rexhepit.

Radio Kosova po ashtu raporton se ministri Beqaj ka shprehur dëshirën që në vend të Integritimeve Evropiane të kalojë në krye të Ministrisë së Financave, por “për postin e ministrit të Financave është në kombinim aktualisht edhe Safete Hadërgjonaj që kryeson Komisionin Parlamentar për Financa, si dhe Behxhet Haliti, shefi aktual i Departamentit të Administratës Tatimore”.

Radio Kosova po ashtu raporton se do të ketë lëvizje edhe në nivelin e zëvendësministrave, ku AKR-së thuhet se do t’i jepen katër poste, ndërsa “në këtë rifreskim pozitiv në Ekzekutivin e vendit, në kombinim për t’u bërë pjesë e strukturës qeverisëse është përmendur gjithashtu edhe emri i Kadri Veselit”.

PDK-ja, përmes komunikatës, ka demantuar këtë raportim të Radio Kosovës, duke e quajtur atë një spekulim medial.

“Edhe sot, si disa ditë më parë rreth përbërjes së Kryesisë së PDK-së, po qarkullojnë informata spekulative rreth formatimit të Qeverisë, duke u përmendur emra të caktuar, rokada apo emërime”, ka thënë PDK-ja në reagimin e saj.

“PDK-ja e ndien obligim para opinionit publik, por edhe para medieve se emrat që po përmenden rreth gjoja formatimit a riformatimit të Qeverisë s’janë gjë tjetër veçse spekulim”, ka insistuar PDK-ja.

Rumania mendon për njohjen e Kosovës

Prishtinë, 3 mars - Do të ishte gabim në qoftë se Rumania nuk i merr parasysh ndryshimet dhe përpimet lidhur me Kosovën dhe “të vazhdojë të mbetet e ngulitur në vijën e parë sikurse ushtari japonez në Oqeanin Paqësor pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, ka thënë ministri i Punëve të Jashtme i Rumanisë, Titus Korlacean.

Këtë deklaratë ministri Korlacean e ka bërë në një televizion rumun, duke iu përgjigjur pyetjes nëse Rumania do t’i bashkohet trendit evropian sa i përket njohjes së pavarësisë së Kosovës.

“Në Kosovë ekziston një realitet politik, të cilin duhet trajtuar në mënyrë inteligjente dhe të hapur”, ka thënë ministri rumun, raporton agjencia serbe e lajmeve Beta.

“Rumania duhet të shikojë me kujdes se si po zhvillohet dialogu politik në mes Kosovës dhe Serbisë, i cili ndërmjetësohet nga përfaqësuesja e lartë e BE-së për Politikë të Jashtme, Catherine Ashton. Ky është realiteti të cilin Bukureshti duhet ta ketë parasysh”, tha ministri i Jashtëm rumun, Korlacean. (telegrafi)